



LISTA

Dritëhijet e Kandidatëve

RAPORT MONITORIMI

Mars 2025



AUTOR
LORELA ALIA



www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

1.	HYRJE	3
2.	METODOLOGJIA	4
3.	SISTEMI ZGJEDHOR NË SHQIPËRI PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE .	4
4.	MEKANIZMAT E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NË PARTITË KRYESORE	6
5.	ANALIZË MBI MEKANIZMAT E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NË ZGJEDHJET E VITIT 2025	10
6.	LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË NËN HETIM NGA SPAK	16
7.	GJETJET KRYESORE	18
8.	REKOMANDIME	19
9.	ANEX	20
10.	REFERENCA	41

1. HYRJE

Demokracia e brendshme brenda partive politike është një faktor kyç për cilësinë e përfaqësimit në parlament dhe funksionimin e një sistemi demokratik të shëndetshëm. Proceset e hapura dhe transparente në përzgjedhjen e kandidatëve jo vetëm që rrisin legjitimitetin e përfaqësuesve politikë, por gjithashtu forcojnë lidhjen mes qytetarëve dhe institucioneve. Kur partitë politike operojnë me parime demokratike të brendshme, ato jo vetëm që sigurojnë një bazë më të gjerë mbështetjeje publike, por edhe promovojnë liderë më të aftë dhe më të përgjegjshëm.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 do të shërbejnë për të vlerësuar treguesit kryesorë të zhvillimit të proceseve demokratike. Në këtë kontekst, përzgjedhja e kandidatëve për deputetë është një proces që do të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e qeverisjes dhe politikave publike. Kandidatët jo vetëm që përfaqësojnë qytetarët në Kuvend, por ata gjithashtu kanë një rol kyç në hartimin e politikave dhe reformave të ardhshme. Për këtë arsye, mënyra se si partitë politike i përzgjedhin kandidatët e tyre është thelbësore për të garantuar një demokraci funksionale dhe efektive.

Ky raport synon të analizojë nëse partitë politike në Shqipëri po aplikojnë kritere meritokratike në përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë. Gjithashtu ky raport do të bazohet në analizën e kritereve të vendosura nga partitë kryesore për përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë dhe rregulloreve të secilës parti, me qëllim kuptimin e shkallës së demokracisë në marrjen e këtyre vendimeve apo nëse ato përcaktohen në mënyrë autoritare nga kryetari.

Rezultatet e tona do të ndihmojnë në kuptimin e nivelit të demokracisë së brendshme të partive dhe ndikimin e tij në cilësinë e përfaqësimit politik në Shqipëri.

2. METODOLOGJIA

Metoda e monitorimit:

- Vëzhgimi i proceseve të brendshme të përzgjedhjes së kandidatëve në partitë kryesore, duke analizuar format e emërimit (primaret, emërimet nga kryetari) dhe rregulloret e brendshme të partive politike.
- Analiza e dokumenteve zyrtare të partive mbi procedurat dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve.
- Vëzhgimi dhe shqyrtimi i rregulloreve të brendshme të dy partive kryesore, si dhe platformave të prezantuara prej tyre, të tilla si "Brain Gain", "Deputeti që duam" etj.
- Analiza e profileve të të gjithë kandidatëve të këtyre dy partive për të vlerësuar nivelin e transparencës dhe konkurrencës në përzgjedhjen e tyre.

Metodologjia e kërkimit:

Ky studim do të përdorë një qasje të kombinuar, duke ndërthurur metoda cilësore dhe sasiore për të ofruar një analizë sa më të saktë dhe gjithëpërfshirëse mbi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Metodatat cilësore do të përfshijnë shqyrtimin e rregulloreve dhe dokumenteve zyrtare, ndërsa metodatat sasiore do të fokusohen në analizën statistikore të përbërjes së kandidatëve dhe përputhshmërinë e tyre me kriteret e përcaktuara nga partitë politike.

3. SISTEMI ZGJEDHOR NË SHQIPËRI PËR ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Që prej zgjedhjeve të para demokratike në vitin 1991, Shqipëria ka përdorur sisteme të ndryshme zgjedhore, duke kaluar nga sistemi majoritar në atë proporcional dhe më pas në një model të përzier. Aktualisht, sipas ndryshimeve të Kodit Zgjedhor të korrikut 2024, vendi aplikon një sistem proporcional rajonal me lista shumëemërore në 12

qarqe zgjedhore, që përputhen me ndarjen administrative të vendit.¹ Subjektet zgjedhore (partitë politike, koalicione dhe grupe zgjedhësish) duhet të kapërcejnë pragun 1% në nivel kombëtar për t'u futur në garën e fitimit të mandateve.

Votuesit kanë dy mundësi:

1. **Lista shumëemërore me renditje të mbyllur**, ku kandidatët paraqiten sipas një rendi të përcaktuar nga vetë subjekti politik dhe shpërndarja e mandateve bëhet sipas kësaj renditjeje.
2. **Lista shumëemërore e hapur**, ku votuesit mund të shprehin preferencën e tyre me votë preferenciale për kandidatët individualë, duke ndikuar në renditjen e tyre në listë.

Këto amendamente synojnë të rrisin transparencën, përfaqësimin dhe efektivitetin e sistemit zgjedhor, duke i ofruar votuesve më shumë kontroll mbi përfaqësuesit e tyre në parlament.

Për herë të parë në historinë e Shqipërisë, diaspora do të ketë mundësinë të ushtrojë të drejtën e saj për të votuar në zgjedhjet e 11 majit 2025. Ky proces ka ngjallur një interes të jashtëzakonshëm, siç reflektohet në numrin e lartë të aplikimeve për regjistrim në listën e votuesve jashtë vendit.

Nga 365,166 kërkesa të paraqitura në Sistemin e Përkohshëm të Regjistrimit (PER), janë miratuar 245,975 votues, të cilët do të kenë mundësinë të votojnë, ndërsa 119,139 aplikime janë refuzuar për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm. Vota e diasporës do të numërohet në qarkun ku votuesi ka qenë i regjistruar përpara largimit nga Shqipëria, duke ndikuar drejtpërdrejt në përbërjen e përfaqësimit politik në nivel qarku.²

¹ Progress, C. (n.d.). QBZ - Qendra e Botimeve Zyrtare. <https://qbz.gov.al/preview/75122d2e-9ebc-45de-b0ea-b5efde2f6836>

² Statistikat e Përdorimit. (n.d.). <https://kqz.al/stats/>

Ky proces shënon një hap të rëndësishëm drejt përfshirjes së komunitetit shqiptar jashtë vendit në jetën politike dhe vendimmarrëse të Shqipërisë.

4. MEKANIZMAT E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NË PARTITË KRYESORE

Gjatë tri dekadave të tranzicionit politik, Shqipëria është përballur me një fenomen shqetësues, numrin e lartë të deputetëve, ministrave dhe kryetarëve të bashkive të dënuar për përfshirje në krim të organizuar, korrupsion apo shpërdorim detyre. Kjo situatë ka dëmtuar besimin e qytetarëve te politika dhe ka ngritur pyetje serioze mbi procesin e përzgjedhjes së kandidatëve politikë si dhe mbi nivelin e meritokracisë brenda partive politike dhe zgjedhjeve.

Partitë politike kanë vendosur mekanizmat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në listat zgjedhore. Ky moment përbën një mundësi për të vlerësuar nëse këto parti po respektojnë parimet e demokracisë dhe meritokracisë apo nëse vazhdojnë të riprodhojnë një elitë politike të bazuar më tepër në lidhjet klienteliste dhe interesat e ngushta sesa në aftësitë dhe integritetin e kandidatëve.

Partitë politike në Shqipëri mund të ndahen në tri kategori kryesore referuar peshës elektorale të historikut të zgjedhjeve:

- 1. Partitë tradicionale dhe më të mëdha** – Partia Socialiste (PS), Partia Demokratike (PD) dhe Partia e Lirisë (PL) kanë dominuar skenën politike dhe kanë pasur ndikim të madh në qeverisjen e vendit.
- 2. Partitë e vogla të vjetra** – si Partia Republikane, Partia Socialdemokrate, Partia Agrare Ambientaliste Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut si dhe Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar të cilat shpesh kanë funksionuar si aleate të partive të mëdha, duke u atashuar me kandidatë

përfaqesues në listat e tyre, por pa u provuar realisht në elektorat, kjo specifikisht pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008.

3. Partitë e reja – si "Shqipëria Bëhet", "Lëvizja Bashkë" dhe "Partia Mundësia" e Partia Nisma Thurje, Koalicioni Euroatlantik apo Djathta 1912, të cilat synojnë të sjellin alternativa të reja, por që përballen me sfida të mëdha për t'u afirmuar në skenën politike.

Megjithëse Shqipëria funksionon në një sistem shumëpartiak, mungon një legjislacion specifik që të detyrojë partitë të aplikojnë një sistem meritokratik për përzgjedhjen e kandidatëve. Në teori, demokracia e brendshme partiake duhet të sigurojë një garë të hapur dhe konkurruese për pozicionet drejtuese dhe kandidaturat për deputetë, por në praktikë, shumica e partive nuk e zbatojnë këtë parim.

Partia Demokratike e Shqipërisë (PD)

Për herë të parë, PD ka vendosur të zhvillojë primaret si një metodë për përzgjedhjen e kandidatëve për deputetë, një praktikë e zakonshme në vendet demokratike perëndimore. Ky vendim është miratuar nga Këshilli Kombëtar i PD-së, ku në pikën e parë të rregullores së miratuar thuhet:

*"Seleksionimi dhe përzgjedhja e kandidatëve zyrtarë të PDSH-së për zgjedhjet parlamentare të datës 11 maj 2025, në Republikën e Shqipërisë, kryhet nëpërmjet votimit të drejtpërdrejtë të anëtarësisë së PDSH-së, sipas parimit 'një anëtar, një votë'."*³

Primaret e Partisë Demokratike (PD) për zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025 u zhvilluan më 1 mars 2025, duke përfshirë rreth 50,000 anëtarë në të gjithë vendin. Ky vendim synon të rrisë demokracinë e brendshme dhe transparencën në përzgjedhjen e kandidatëve.

³ Rregullore për Primaret. (2025). PD. <https://pd.al/wp-content/uploads/2022/11/VENDIMI-38-PER-RREGULLOREN-E-PER-PRIMARET-NE-ZGJEDHJET-VENDORE.pdf>

PD gjithashtu ka krijuar departamentin *Brain Gain* në tetor të vitit 2022, i cili ka për qëllim hapjen e partisë dhe pasurimin e saj me burime njerëzore duke afruar në radhët e saj të rinj nga jashtë. Megjithatë, mekanizmi konkret i përzgjedhjes së kandidatëve përmes kësaj platforme nuk është ende i përcaktuar qartë⁴, por në Primaret e zhvilluara pati kandidatë që erdhën edhe nga radhët e këtij departamenti.

Partia Socialiste (PS)

PS nuk ka zhvilluar zgjedhje të brendshme për përzgjedhjen e kandidatëve dhe nuk e ka të parashikuar në statutin apo rregulloren e saj mbajtjen e primareve përpara zgjedhjeve parlamentare. Në vend të kësaj, PS ka përdorur platformën "Deputeti që duam"⁵, një mekanizëm inovativ që synon të përfshijë qytetarët në procesin politik.

Përmes kësaj platforme, çdo individ i interesuar mund të aplikojë për t'u bërë pjesë e listës së kandidatëve të PS-së duke plotësuar një formular online, i cili përfshin:

- Të dhënat personale dhe një jetëshkrim;
- Dy letra mbështetëse;
- Një video deri në 3 minuta, ku kandidati prezanton motivimin, përvojën dhe vizionin e tij politik.

Një komision i posaçëm brenda PS-së vlerëson kandidatët mbi bazën e informacionit dhe dokumenteve të paraqitura. Ky mekanizëm synon të afrojë qytetarët me procesin politik dhe të sigurojë një përzgjedhje më transparente të kandidatëve. Megjithatë, mbetet e paqartë në çfarë mase kjo platformë do të ndikojë realisht në përzgjedhjen e

⁴ Departamenti Brain Gain - Partia Demokratike e Shqipërisë. (n.d.). Partia Demokratike E Shqipërisë. <https://pd.al/strukturat/departamentet/departamenti-brain-gain-ekselenca/>

⁵ Deputeti që duam | Partia Socialiste e Shqipërisë. (n.d.). <https://deputetiqeduem.al/>

kandidatëve, duke qenë se vendimmarrja përfundimtare i mbetet strukturave të partisë.

Përzgjedhja e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 në Shqipëri tregon një ndryshim të lehtë në qasjen e partive politike ndaj transparencës dhe demokracisë së brendshme. PD ka bërë një hap përpara duke adoptuar një proces gare të hapur, ndërsa PS ka prezantuar një platformë që mund të rrisë përfshirjen qytetare, por me vendimmarrje të centralizuar brenda partisë.

Në mungesë të një legjislacioni që garanton meritokracinë në përzgjedhjen e kandidatëve, mbetet për t'u parë nëse këto mekanizma do të sjellin ndryshime afategjata dhe domethënëse apo do të mbeten procese formale, pa ndikim të madh në cilësinë dhe integritetin e kandidatëve të zgjedhur.

Partitë e reja

Partitë e reja shpesh hyjnë në skenën politike shqiptare me premtimin për të sjellë një ndryshim thelbësor, duke akuzuar formacionet tradicionale për mungesë lirie dhe demokracie. Megjithatë, praktikat e tyre në përcaktimin e kandidatëve për deputetë tregojnë se ato nuk ndryshojnë ndjeshëm nga partitë e vjetra.

Një nga problemet kryesore lidhet me mungesën e transparencës dhe të proceseve demokratike në përzgjedhjen e kandidatëve. Partitë si "Lëvizja Bashkë" dhe "Shqipëria Bëhet" nuk e kanë të përcaktuar në statut mekanizmin e selektimit të kandidatëve për listat zgjedhore, duke krijuar pasiguri mbi mënyrën se si përzgjidhen kandidatët për deputetë. Nga ana tjetër, partia "Mundësia" në statutin e saj parashikon që "kandidaturat për zgjedhjet parlamentare, këshillat bashkiakë dhe për kryetar bashkie të seleksionohen në bashkëpunim dhe konsultim aktiv me anëtarët e Partisë". Megjithatë, ky përcaktim mbetet i përgjithshëm dhe nuk ofron mekanizma të qartë për procesin e përzgjedhjes, duke mos garantuar transparencën.

Pavarësisht retorikës për ndryshim, faktet tregojnë se partitë e reja nuk kanë arritur të vendosin standarde më të larta në procesin e brendshëm demokratik të përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë. Për rrjedhojë, sfida e vërtetë për to mbetet ndërtimi i mekanizmave të qartë dhe transparentë që do të garantonin përfaqësim të drejtë dhe besueshmëri më të madhe në sytë e publikut.

5. ANALIZË MBI MEKANIZMAT E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE NË ZGJEDHJET E VITIT 2025

Një aspekt i rëndësishëm i procesit zgjedhor është përzgjedhja e kandidatëve, mekanizmat e aplikuar dhe transparenca e tyre. Historikisht, në 35 vitet e fundit të demokracisë shqiptare, partitë politike nuk kanë zhvilluar primare për përzgjedhjen e listave të kandidatëve për deputetë. Kjo mungesë e procedurave të hapura rrjedh nga mungesa e demokracisë së brendshme brenda partive politike shqiptare.

Për herë të parë, Partia Demokratike (PD) organizoi primare për zgjedhjet e vitit 2025, duke mundësuar një garë të brendshme mes kandidatëve. Zgjedhjet u zhvilluan në kushte të mira, me pjesëmarrjen e rreth 50,000 demokratëve, të cilët votuan dhe përzgjodhën kandidatët e tyre të preferuar. Megjithatë, pas publikimit të rezultateve, kryetari i PD, Z. Sali Berisha, deklaroi se pavarësisht votës së fituar në primare, kandidatët nuk do të kishin garanci automatike për të qenë pjesë e listave përfundimtare.

Tabela 1. Kandidatë për deputet që kanë marrë pjesë në primare


Kategoria	Numri	Përqindja (%)
Kandidatët total në listë	186	100%
Kandidatët nga primaret	101	54.3%
Nga primaret në listë të mbyllur	18	9.7%

Nga primaret në listë të hapur	83	44.6%
Nuk e kanë kaluar pragun, por në listë	33	17.7%
Kanë kaluar pragun total	68	36.6%
Nga ata që kanë kaluar pragun, në listë të mbyllur	18	9.7%
Nga ata që kanë kaluar pragun, në listë të hapur	50	26.9%

Tabela 2. Kandidatë për deputet që kanë marrë pjesë në primare në 12 qarqe

Qarku	Kandidatë për deputet që kanë marrë pjesë në primare	Në listë të mbyllur	Në listë të hapur	Nuk e kanë kaluar pragun	% në listë të mbyllur	% në listë të hapur	% nuk e kanë kaluar pragun
Tiranë	21	1	20	3	4.8%	95.2%	14.3%
Durrës	12	2	10	4	16.7%	83.3%	33.3%
Kukës	2	0	2	0	0%	100%	0%
Shkodër	10	2	8	2	20%	80%	20%
Korçë	8	2	6	3	25%	75%	37.5%
Vlorë	5	2	3	2	40%	60%	40%
Berat	5	1	4	3	20%	80%	60%
Gjirokastër	4	0	4	0	0%	100%	0%
Elbasan	12	3	9	5	25%	75%	41.7%
Lezhë	4	1	3	0	25%	75%	0%
Dibër	5	1	4	3	20%	80%	60%
Fier	13	3	10	8	23.1%	76.9%	61.5%
Total	101	18	83	33	17.8%	82.2%	32.7%

Grafiku 1. Kandidatë për deputet që kanë marrë pjesë në primare në 12 Qarqe



PD zhvilloi primare për të mundësuar një garë të hapur mes kandidatëve dhe vendosi pragje specifike në secilin qark për të garantuar që vetëm ata me mbështetje të mjaftueshme të përfshiheshin në listën përfundimtare. Megjithatë, analizimi i listës së miratuar tregon se ky kriter nuk është zbatuar në mënyrë konsistente, duke rezultuar në një mospërputhje të dukshme mes rezultatit të primareve dhe përbërjes së listës përfundimtare të kandidatëve.

Nga 186 kandidatët në total, PD përfshiu vetëm 101 kandidatë nga procesi i primareve, (54.3% të listës) të ndarë në 18 në listën e mbyllur dhe 83 në listën e hapur. Nga këta, 33 (17.7% të listës) nuk e kishin kaluar pragun e vendosur nga Këshilli Kombëtar i PD-së, që varion në çdo qark, por megjithatë u përfshinë në listë. Kjo bie ndesh me Vendimin Nr.31 date 12.02.2025 të miratuar nga Këshilli Kombëtar i PD-së, "miratimi i rregullores mbi modalitetet e përzgjedhjes së kandidatëve në zgjedhjet për Kuvendin më 11 maj 2025" duke ngritur pikëpyetje mbi koherencën dhe respektimin e rregullave të brendshme të partisë. Për më tepër, nga 68 kandidatët që kishin kaluar pragun, (36.6% të listës) (Tabela 2), 18 u përfshinë në listën e mbyllur dhe 50 në

listën e hapur, duke krijuar një hendek të qartë midis pritshmërive të procesit dhe vendimmarrjes përfundimtare. Nga 38 kandidatët më të votuar nga lista e PD, vetëm 7 kandidatë nga primaret u futën në listat e mbyllura dhe 11 të tjerë në listat e hapura (Tabela 1, Anex). Nga 12 kandidatët më të votuar në 12 qarqet e Shqipërisë, vetëm 5 u futën në listat e mbyllura dhe 2 në ato të hapura.⁶

Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për deputetë nga Partia Demokratike (PD) për zgjedhjet e ardhshme ngre shqetësime mbi respektimin e demokracisë së brendshme dhe transparencës. Kur një parti politike nuk respekton parimet e veta të brendshme të garës dhe përfaqësimit, rrezikon të dobësojë mobilizimin elektoral dhe të dëmtojë perceptimin publik mbi angazhimin e saj për ndryshim politik.

Kjo tregon se primaret u zhvilluan kryesisht për dy arsye kryesore:

1. Testimi i anëtarësisë së PD dhe përkushtimit të strukturave të saj;
2. Krijimi i një perceptimi të demokracisë së brendshme dhe meritokracisë, ndonëse lista finale tregoi se përzgjedhja e kandidatëve varet ende nga vendimet e elitave të vjetra dhe jo nga vota e anëtarësisë.

Një tjetër platformë "Brain Gain," e cila kishte për qëllim angazhimin e të rinjve të arsimuar jashtë vendit. Megjithatë, vetëm një kandidat nga kjo platformë, Tedi Kopliku, arriti të përfshihej në listat e hapura të PD, duke treguar se mekanizmat e tillë shërbejnë më shumë për strategji politike sesa për krijimin e një meritokracie të vërtetë. Kandidatët nga diaspora në listat e PD numërohen 7, të gjithë të pozicionuar në listat e hapura. PD ka përfshirë në listat e saj 40 deputetë aktualë, nga të cilët 24 janë vendosur në listë të mbyllur dhe 16 në listë të hapur. Gjithashtu,

⁶ Listat e PD/ Po primaret pse u bënë?! Berisha "fshin" të preferuarit e anëtarësisë! Sula e Kadiu të parët por u lanë jashtë! Më të votuarit e Tiranës jo të sigurt (EMRAT). (2025, March 13). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/listat-e-pd-po-primaret-pse-u-bene-berisha-fshin-te-preferuarit-e-anetaresise-sula-e-kadiu-te-paret-por-u-lane-jashte-me-te-votuarit-e-tiranes-jo-te-sigurt>

ka përfshirë 20 ish-deputetë, prej të cilëve 8 janë në listë të mbyllur dhe 12 në listë të hapur. (Tabela 2, Anex)

Struktura e listës së PD:

- 40 deputetë aktualë (24 në listë të mbyllur, 16 në listë të hapur);
- 20 ish-deputetë (8 në listë të mbyllur, 12 në listë të hapur);
- 1 kandidat nga platforma "Brain Gain";
- 4 kandidatë nga FRPD (1 në listë të mbyllur dhe 3 në listë të hapur).

Nga ana tjetër, Partia Socialiste (PS), e cila ka 12 vite në pushtet, ka promovuar mekanizmin "Deputeti që duam." Ky mekanizëm nuk është transparent, pasi procesi i aplikimit konsiston vetëm në dorëzimin e një CV-je dhe një videoje prezantuese, ndërsa kriteret e përzgjedhjes mbeten të panjohura. Megjithatë, PS ka përfshirë 18 kandidatë nga platforma "Deputeti që duam", ku 7 janë në listën e mbyllur dhe 11 në listën e hapur.

Nga analiza e listave, rezulton se PS ka zgjedhur të promovojë figura të reja,⁷ për shkak të konsumit politik pas 12 viteve në pushtet dhe skandaleve të shumta, që kanë përfshirë ministra, kryetarë bashkie dhe deputetë. Gjithashtu, përzgjedhja e kandidatëve synon të forcojë kontrollin e kryetarit të partisë, duke zvogëluar hapësirën për kundërshtim të brendshëm. Deputetët me peshë janë vendosur në listat e hapura, duke i detyruar të luftojnë për vota.

PS ka vendosur vetëm 48 deputetë aktualë në listat e saj, duke lënë jashtë 24 deputetë të papërfshirë. Nga 36 deputetë, janë vendosur në lista të hapura, ndërsa vetëm 12 në zona të sigurta. Gjithashtu, PS ka përfshirë në lista të hapura edhe 6 ish-deputetë. (Tabela 3, Anex)

⁷ Voa. (2024, September 8). Zgjedhjet 2025, PS synon emra të rinj për parlamentin e ardhshëm. Voice of America. <https://www.zeramerikes.com/a/7776129.html>

Struktura e listës së PS:

- 12 deputetë aktualë në listat e mbyllura;
- 36 deputetë aktualë në listat e hapura;
- 6 ish-deputetë në listat e hapura;
- 18 kandidatë nga platforma "Deputeti që duam" (7 në listë të mbyllur dhe 11 në listë të hapur);
- 2 kandidatë nga diaspora (1 në listë të hapur, 1 në listë të mbyllur).

Megjithëse diaspora ka shprehur interes të lartë për të votuar në zgjedhjet e vitit 2025, përfaqësimi i saj mbetet minimal, me vetëm dy kandidatë në listat e PS, të dy nga qarku i Shkodrës. Kjo tregon një mospërfillje ndaj rolit të diasporës në vendimmarrjen politike në Shqipëri.

Përmbledhtazi, mekanizmat e përzgjedhjes së kandidatëve nuk kanë sjellë ndonjë ndryshim thelbësor në strukturat politike.

Në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, vihet re një tendencë drejt formave autoritare dhe jodemokratike, pavarësisht diskursit publik mbi garën dhe transparencën. Propaganda e zhvilluar mbi platformën e përzgjedhjes së kandidatëve nuk pasqyron realitetin, pasi të dhënat tregojnë se individët me mbështetjen më të lartë nuk janë vendosur në pozicionet e merituar. Mungesa e transparencës është e dukshme në lidhje me kriteret e përzgjedhjes, numrin e votave të marra nga kandidatët dhe mekanizmat e vendimmarrjes.

Partia Socialiste, me synimin për të maksimizuar votat, ka hartuar një listë kandidatësh pa një karrierë të mëparshme politike apo një profil të spikatur publik, ndërkohë që ka hapur një garë të fortë për politikanët e karrierës. Në të kundërt, Partia Demokratike ka ndjekur një qasje tjetër, duke shpërblyer besnikët dhe aleatët e saj në funksion të forcimit të strukturave të brendshme partiake.

Ndërsa PS ka ndjekur një strategji të rinovimit për arsye pragmatike, PD ka mbetur brenda dinamikave tradicionale të lidërshiptit të saj. Diaspora dhe të rinjtë vazhdojnë të jenë të përfaqësuar minimalisht, duke reflektuar një tendencë të vazhdueshme të partive politike për të ruajtur strukturat e tyre ekzistuese.

6. LISTA E KANDIDATËVE PËR DEPUTETË NËN HETIM NGA SPAK

Lista aktuale e kandidatëve për deputetë përfshin 15 emra që ndodhen nën hetim nga SPAK: 8 nga Partia Demokratike, 5 nga Partia Socialiste dhe 2 nga Partia e Lirisë. Prania e figurave të akuzuara për korrupsion, pastrim parash dhe shpërdorim detyre në listat e partive kryesore tregon se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve mbetet i dobët, jodemokratik dhe i papërgjegjshëm.

Kjo situatë dëshmon se partitë politike vazhdojnë të përsërisin gabimet e së kaluarës dhe nuk respektojnë organet e drejtësisë. Institucioni ynë ligjvënës rrezikon të përbëhet nga individë me probleme serioze ligjore, duke dëmtuar besimin e qytetarëve në institucionet demokratike dhe vetë funksionimin e shtetit të së drejtës.

Tabela 3. Lista e kandidatëve për Deputetë nën hetim nga SPAK

Partia	Kandidati	Qarku	Akuza nga SPAK	Statusi
PD	Sali Berisha ⁸	Tiranë	Korrupsion (Klubi Partizani), 21 Janari	I pandehur
PD	Belind Këlliçi ⁹	Tiranë	Falsifikim dokumentesh, mosdeklarim pasurie	Nën hetim
PD	Flamur Noka ¹⁰	Tiranë	Pastrim parash, fshehje pasurie	Nën hetim

⁸ Njoftim per Shtyp. (2024). SPAK. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-16-10-2024/>

⁹ Njoftim per Shtyp. (2024). SPAK. <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-28-03-2024/>

¹⁰ SPAK nis zyrtarisht hetim pasuror për Flamur Nokën dhe familjen e tij. (2024). Shqiptarja.com. <https://shqiptarja.com/lajm/spak-nis-zyrtarisht-hetim-pasuror-per-flamur-noken-dhe-familjen-e-tij>

PD	Fatmir Mediu ¹¹	Tiranë	Afera e Gërdecit	Në gjykim
PL	Ilir Meta ¹²	Tiranë	Korrupsion, pastrim parash	Nën hetim
PD	Asllan Dogjani ¹³	Tiranë	Fshehje pasurie	Nën hetim
PD	Luan Baçi ¹⁴	Fier	Pastrim parash	Nën hetim
PD	Bardh Spahia	Shkodër	Shpërdorim detyre	Nën hetim
PD	Xhelal Mziu ¹⁵	Dibër	Pastrim parash, fshehje pasurie	Nën hetim
PL	Dashamir ¹⁶ Xhika	Elbasan	Korrupsion mbi tendera kur drejtonte ASHRR	Nën hetim
PS	Klotilda Bushka ¹⁷	Tiranë	Intimidim dëshmitarësh, pengim drejtësie (Dosja "Veliaj")	Nën hetim
PS	Olta Xhaçka ¹⁸	Tiranë	Afera me pronat e ushtrisë, privatizimi i Portit të Sarandës	Nën hetim
PS	Ceno Klosi ¹⁹	Fier	Abuzime në detyrë (ish-drejtor i Tatimeve)	Nën hetim
PS	Pirro Vëngu ²⁰	Tiranë	Abuzime në detyrë (ish-drejtor i Portit të Durrësit)	Nën hetim

¹¹ Fatmir Mediu nën akuzë nga SPAK për shpërdorim detyre: Politike, asnjë provë shtesë. (n.d.). <https://abcnews.al/gerdeci-fatmir-mediu-nen-akuze-nga-spak-per-shperdorim-detyre-politike-asnje-prove-shtese/>

¹² Delia-Kaci, J. (2024). Ish-presidenti Meta arrestohet nën dyshimet për korrupsion. *Radio Evropa E Lirë*. <https://www.evropaelire.org/a/arrestohet-ilir-meta-shajperi-spak-/33166600.html>

¹³ Akuzohet për fshehje pasurie, deputeti i PD-së Asllan Dogjani paraqitet në SPAK. (2025). *Shqiptarja.com*. <https://shqiptarja.com/lajm/deputeti-i-pdse-asllan-dogjani-paraqitet-ne-spak>

¹⁴ SPAK heton deputetin e PD-së Luan Baçi për fshehje pasurie. (2024). *Shqiptarja.com*. <https://shqiptarja.com/lajm/spak-heton-deputetin-e-pdse-luan-baci-per-fshehje-pasurie-shqiptarjacom-zbulon-detajet-kur-ishte-drejtor-i-drshtr-fier-u-hetua-per-korrupsion-me-patentat>

¹⁵ Xhelal Mziu në SPAK për dy tendera pastrimi të 2019-tës, kur deputeti i PD-së ishte kryetar bashkie në Kamëz. (2024). *Shqiptarja.com*. <https://shqiptarja.com/lajm/xhelal-mziu-ne-spak>

¹⁶ Tenderat kur ishte drejtor i ARRSH-së/ Dashamir Xhika, anëtar i kryesisë së Partisë së Lirisë në SPAK për 1 orë e 40 minuta (VIDEO). (2025, February 21). *Shqiptarja.com*. <https://shqiptarja.com/lajm/ishdrejtori-i-arsh-dashamir-xhika-paraqitet-ne-spak>

¹⁷ Dosja e SPAK: Si Klotilda Bushka porositi kushërirën e saj se çfarë duhet të thoshte në Prokurorinë e Posaçme. (n.d.). <https://www.balkanweb.com/ne-shenjester-dosja-e-spak-si-klotilda-bushka-porositi-kusheriren-e-saj-se-çfare-duhet-te-thoshte-ne-prokurorine-e-posacme/#gsc.tab=0>

¹⁸ Olta Xhaçka në SPAK/ Ish-kreu i Krimeve të Rënda: Prokuroria ka gjetur elemente të veprës penale. <https://www.balkanweb.com/olta-xhacka-ne-spak-ish-kreu-i-krimeve-te-renda-prokuroria-ka-gjetur-elemente-te-vepres-penale-gazetari-baza-e-sarandes-eshte-ngrire-mes-personave-te-kallezuar-edhe/#gsc.tab=0>

¹⁹ Ceno Klosi në hetim nga SPAK për 4 vepra penale! <https://www.balkanweb.com/ceno-klosi-ne-hetim-nga-spak-per-4-vepra-penale-nga-korrupsioni-te-fshehja-e-pasurive-ne-londer-dhe-mashtrimi-aferrat-per-te-cilat-akuzohet-ish-kreu-i-tatimeve/#gsc.tab=0>

²⁰ PD dërgon në SPAK një tjetër dosje për ministrin e Mbrojtjes Pirro Vëngu: Favorizoi kompanitë koncesionare, 11 tendera në shkelje. (n.d.). <https://www.balkanweb.com/dem-62-milione-euro-pd->

PS	Plarent Ndreca ²¹	Tiranë	Abnuzime me tenderat për 4 komisaritate	Në gjykim
----	---------------------------------	--------	--	-----------

7. GJETJET KRYESORE

1. Demokracia e brendshme në partitë politike shqiptare mbetet e

kufizuar - Mungesa e mekanizmave meritokratikë bën që përzgjedhja e kandidatëve të vazhdojë të dominohet nga lidhshipi i partive dhe jo nga garat e hapura. Edhe pse Partia Demokratike ka organizuar primare për herë të parë, rezultatet tregojnë se shumica e kandidatëve të zgjedhur nga baza nuk janë përfshirë në listat finale. PD përfshiu vetëm 101 kandidatë nga procesi i primareve, (54.3% të listës) të ndarë në 18 në listën e mbyllur dhe 83 në listën e hapur. Nga këta, 33 (17.7% të listës) nuk e kishin kaluar pragun e vendosur.

Vetëm **18 nga 38 kandidatët më të votuar** u përfshinë në listat përfundimtare (7 në lista të mbyllura dhe 11 në të hapura), duke treguar se vendimmarrja mbeti në duart e elitave partiake. Partia Socialiste ka promovuar platformën "Deputeti që duam", por duke përfshirë **18 kandidatë**, por pa kritere të qarta përzgjedhjeje, procesi mbetet jotransparent, pasi përzgjedhja varet nga vendimmarrja e strukturave qendrore të partisë.

2. Strategji të Ndryshme për Përzgjedhjen e Kandidatëve – PS ka vendosur në listat e saj **48 deputetë aktualë**, ku **36 janë në lista të hapura dhe vetëm 12 në zona të sigurta**, duke krijuar një garë të brendshme. Në të kundërt, PD ka ruajtur dominimin e figurave të njohura, duke përfshirë **40 deputetë aktualë** (24 në lista të mbyllura

[dergon-ne-spak-nje-tjeter-dosje-per-ministrin-e-mbrojtjes-pirro-vengu-favorizoi-kompanite-koncesionare-11-tendera-ne-shkelje/#gsc.tab=0](#)

²¹ <https://www.reporter.al/2024/11/27/spak-dergon-per-gjykim-deputetin-socialist-plarent-ndreca-dhe-15-zyrtare-per-abuzim-me-tenderat/>

dhe 16 në lista të hapura) dhe **20 ish-deputetë** (8 në lista të mbyllura dhe 12 në të hapura).

- 3. Përfaqësim Minimal i Diasporës dhe të Rinjve** – Diaspora vazhdon të mbetet e papërfaqësuar, me vetëm **7 kandidatë në listat e hapura të PD** dhe **2 në listat e PS**. Nga platforma “Brain Gain,” vetëm **1 kandidat** u përfshi në listën e PD, duke treguar se mekanizmat e rinovimit të partive janë më shumë strategji politike sesa mjete të vërteta të meritokracisë.
- 4. Lista aktuale e kandidatëve për deputetë përfshin 15 emra që ndodhen nën hetim nga SPAK:** 8 nga Partia Demokratike, 5 nga Partia Socialiste dhe 2 nga Partia e Lirisë.

8. REKOMANDIME

1. Demokratizimi i proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve të partive politike

Partitë politike duhet të ndërtojnë mekanizma demokratik në përzgjedhjen e kandidatëve për deputet duke i dhënë peshë votës së drejtpërdrejt që vjen nga antarësia. Kjo do të ndikojë në demokratizimin e procesit si dhe do të zvogëlonte përfshirjen e interesave të drejtimit dhe kryetarit nga bërja e listave të kandidatëve.

2. Forcimi i Mekanizmave të Transparencës dhe Përgjegjshmërisë

Për të rritur besimin publik në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, partitë politike duhet të zbatojnë masa të forta transparence, duke përfshirë:

- Publikimin e listës së kriterëve të vlerësimit dhe metodologjisë së përdorur për përzgjedhjen e kandidatëve.
- Raportimin e detajuar mbi pjesëmarrjen e anëtarësisë dhe rezultatin e çdo procesi përzgjedhës, duke garantuar që lista përfundimtare reflekton realisht votën e anëtarësisë.

3. Përfshirja e Diasporës dhe Grupeve të Pafavorizuara në Procesin Politik

Për të garantuar një përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës, partitë duhet të krijojnë mekanizma konkrete për angazhimin e diasporës dhe grupeve të nënpërfaqësuar:

- Vendosja e kuotave të qarta për përfaqësimin e diasporës në listat zgjedhore, duke reflektuar kontributin dhe angazhimin e tyre politik dhe ekonomik.
